

VENDIM
Nr.44, datë 31.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.119, DATË 18.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “A” të kapitullit I, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) fillon menjëherë publikimin. Periudha e publikimit zgjat 30 ditë nga data e publikimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit të jetë data e përcaktuar në njoftimin, që Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dërgon për publikim. Krahës këtij publikimi bëhen njoftime në televizion, në radio, si dhe në internet. Në internet (faqja e Ministrisë së Financave) njoftohen edhe treguesit ekonomikë e teknikë të shoqërisë (llogaritë vjetore).

Kjo procedurë zbatohet në të gjitha rastet e publikimit për shitje të paketave të aksioneve shtetërore.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) vendos pranë shoqërive, që privatizohen dhe në mjediset publike të vendndodhjes së subjektit, afishe me të dhënat e publikuara për këto shoqëri.”.

2. Në pikën 1 të shkronjës “C” të kapitullit I, fjalët “...në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar me akte të tjera nënligjore...” zëvendësohen me “...në mbështetje të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar, për procedurat para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004.”.

3. Në kapitullin II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Brenda 10 ditëve nga marrja e urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (pika 3 e shkronjës “D” kapitulli I), Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) fillon procedurën e publikimit për shitjen e paketës së aksioneve. Afati i publikimit është 30 ditë nga publikimi i parë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe bëhet në çdo botim të tij, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit do të jetë data e përcaktuar në njoftimin, që Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dërgon për publikim. Brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) vendos afishe me të dhënat e botuara për shoqëritë që privatizohen.”.

b) Pas paragrafit të parë të pikës 8 të shkronjës “A”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Pjesëmarrësve të tjerë në ankand u kthehet vlera fillestare, prej 30 përqindësh, vlerë kjo e parapaguar për pjesëmarrje në ankand.”.

c) Pika 9 shfuqizohet.

ç) Pika 2 e shkronjës “B” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Procedurat e shitjes së paketës së aksioneve për publikun fillojnë me publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike. Afati i publikimit është 30 ditë nga publikimi i parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit është data e përcaktuar në njoftimin, që Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dërgon për publikim. Brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) vendos afishe me të dhënat e botuara për shoqëritë që privatizohen.”.

d) Pas pikës 9 të shkronjës “C” shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Në rastin kur kapitali themeltar i shoqërisë aksionare nuk ka ndryshim nga publikimi për privatizimin e shoqërisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës urdhëron transferimin e paketës së aksioneve në favor të ish-pronarëve të trullit (kur kjo procedurë nuk është realizuar), pa e shoqëruar me dokumentacion, sipas pikës 2 të këtij vendimi.”.

4. Kudo në vendim, për aq sa nuk është prekur nga ky ndryshim, emërtimet “Ministria e Ekonomisë, Publike dhe Privatizimit”, “Ministria e Ekonomisë” dhe “Agjencia Kombëtare e Privatizimit e degët e saj në rrethe” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” dhe “Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike)”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha